

■ **HULUMTIM: KEQPËRDORIMI I PRONËS INTELLEKTUALE**

# PIRATERIA RADIODIFUZIVE "USHQEHET" ME "KAOS" LIGJOR

Rregullimet në sferën e radiodifuzionit deri më tani nuk janë prekur, prandaj në momentin që do të preket nga Këshilli për Radiodifuzion vlerësojnë se do të hapet "Kutia e Pandorës". "Këtu do të vërehen shumë marrëzira, por më e rëndësishme është se do të konstatohen të gjitha dobësitë", thotë Kryetari i Këshillit për Radiodifuzion, Zoran Stefanoski

**BARDHYL ZAIMI-URIM HASIPI**

Pirateria me programet kompjuterike mbetet "biznes" shume profitabil. Programet e palicencuara tashmë paraqesin "normalitet" për kompjuterët personal të qytetarëve, për kompjuterët e internet caffeeve dhe të kompanive. Kohë më parë, Aleanca e botërore e biznes-sofuerit ka reaguar ndaj shfrytëzimit jolegal të programeve kompjuterike. Sipas kësaj Aleance, mbi 60 për qind e qytetarëve të Maqedonisë shfrytëzojnë softuer jolegal. Kjo Aleancë ka bërë të ditur se softueri jolegal dhe mbrojtja e pamjaftueshme e pronës intelektuale ndikojnë drejtpërdrejt në thithjen e kapitalit të huaj në Maqedoni. Specialistët e kësaj fushe, por edhe përfaqësues juridik të kompanive për mbrojtjen e programeve legale kompjuterike thonë se për shkak të mbrojtjes së pamjaftueshme shteti humb miliona euro në vit. Përfaqësuesi i Biznes-sofuer Aleancës, Vladimir Pepelugovski, kohë më parë ka bërë të ditur për vështirësitë në parandalimin e piraterisë me softuerët. Sipas tij, shumë më tepër fitohet nëse shitet një softuer jolegal, që kushton 100, 200 dhe ndonjëherë edhe mijëra euro, sesa të shitet një gram kokainë. Specialistët që vihen në mbrojtje të programeve legale kanë bërë të ditur se kjo lloj piraterie paraqet kriminalitetin e së ardhmes. Edhe në hapësirën radiodifuzive mbretëron kaosi. Me këtë kaos të pa rregulluar siç duhet me ligj "ushqehet" pirateria në shumë kanale televizive, të cilët pa mar-

rëveshje të nënshkruara për të drejtën autoriale emetojnë programe që vijnë nga kanale të huaja televizive. Janë vërejtur brenda kohës emetime "ekskluzive", sidomos nga ngjarjet sportive, në dy servise përmjeherësh. Në Këshilli për Radiotelevizion e pohojnë këtë rregullim që vjen si pasojë e mungesës së inspektimit dhe si pasojë e sanksioneve të lehta ligjore.

**KRD-ja në aksion**

Kryetari i Këshillit për Radiodifuzion, Zoran Stefanoski thotë se meqë këtë materie akoma nuk e kemi të rregulluar me ligj, kemi vendosur të shfrytëzojmë atë që kemi në dispozicion, pra brenda Këshillit të formojmë një sektor që do të merret me piraterinë në radiodifuzion.

"Tani për tani këtë nismë do ta mbështesim në një rregullore, e cila do të mbështet në ligjin aktual dhe që do të shërbejë për të ndërmarrë aksion në këtë drejtim. Kemi ndërmend gjithashtu që Këshilli për Radiodifuzion të nënshkruaj një memorandum me Ministrinë e Kulturës me të cilin do të rregullohet procedura e aksionit", thotë ai. Nëpërmjet këtij memorandumit së pari pritet të detektohet pirateria dhe së dyti të ndërmerret aksion i përbashkët në këtë drejtim. "Me këtë do të funksionojmë si institucione. Por kjo me siguri nuk do të mjaftojë, mendoj se më kompetente përsëri mbetet Trupi Koordinues për mbrojtjen e pronës intelektuale, i cili realisht përfshinë me tepër institucione dhe mund të jetë më efikase", thotë Ste-



fanoski.

Këshilli për Radiodifuzion ka kompetenca për t'i sanksionuar keqpërdorimet, piraterinë në sferën radiodifuzive, por dënimet janë të lehta. Ky Këshill kërkon dënime rigorozë për ata që e shkelin ligjin. "Ne duhet ta themi se njëri ndër problemet për hyrje në BE mbetet garantimi i të drejtave autoriale", thotë Stefanoski.

Deri më tani nuk janë ndërmarrë sanksionime ndaj subjekteve radiodifuzive që kanë shpërdoruar të drejtat autoriale, por më tepër ky këshill është marrë me regjistrimin e paketave të rrjeteve komunikuese, të cilët posedojnë marrëveshje të dyshimta për rregullimin e të drejtave autoriale. Në një punëtori të organizuar nga ky këshill është trajtuar kjo problematikë. Stefanoski kërkon që Këshilli për radiodifuzion të hartojë listë të zezë dhe të bardhë të serviseve mediale, që shfaqen në treg. Lista e bardhë do të përfshinte të gjitha ato servise që realisht funksionojnë me të drejta autoriale të rregulluara, ndërsa lista e zezë do të përfshinte ato servise që nuk mund të rriemtojnë në tërësi programe. Këtu futen të gjitha programet nga ish-republikat jugosllave. Ato emetohen pa leje. Stefanoski thotë se ekziston problemi me transmetimin e shumë ngjarjeve sportive ndërkombëtare, të cilat emetohen në disa medime si ekskluzive.

"Nëse një servis nuk mund të nënshkruaj marrëveshje për të drejtat autoriale dhe për rriemtim të plotë të programit kjo konsiderohet si shkelje e ligjit, prandaj edhe në këtë drejtim do të duhet të rishqyrtohen shumë gjëra, sepse këto kanale televizive do t'i fusim në listën e zezë", thotë kryetari Stefanoski.

**Kërkohe zgjidhje ligjore**

Rregullimet në sferën e radiodifuzionit deri më tani nuk janë prekur, prandaj në momentin që do të preket nga Këshilli për Radiodifuzion vlerësojnë se do të hapet "Kutia e Pandorës". "Këtu do të vërehen shumë marrëzira, por më e rëndësishme është se do të konstatohen të gjitha dobësitë. Ne jemi të vendosur në këtë, por na duhen masa represive

ligjore që të mund t'i sanksionojmë. Ne rrotullohemi në vend. Duket qesharak një dënim prej 2 mijë eurosh, sidomos kur kemi parasysh që një numër i madh i lendeve vjetërsohen në gjyq dhe kjo nuk është korrekte. Pra duhen inspektime konkrete dhe dënime konkrete, marrje e lejes për emetim dhe marrje e të drejtës si operator i rrjetit komunikues", thotë Stefanoski.

Shumë kompani të mëdha nuk lejohen që të futen vetëm, por iu sugjerohet që të futen në një paket me të tjerët, në emër të të drejtave kolektive autoriale. Për Stefanoskin kjo nuk duket e logjishme, por e dyshimtë. "Ne duhet të gjejmë mënyra që të kontaktojmë me këto përfaqësues të kompanive dhe të legjitimohe në Këshillin për radiodifuzion dhe ato duhet të kenë marrëveshje gjenerale për përfaqësim. Me këtë do të mund të vërtetojmë nëse ata janë kuazipërfaqësues apo përfaqësues të vërtetë", thotë ai. Të gjitha paketat që aktualisht janë të pranishme shfaqen si të dyshimta për rregullshmërinë e marrëveshjeve të tyre. Anëtarët e Këshillit tashmë janë të bindur se duhet të qartësohen punët. Disa nga ta kanë propozuar që të fillohet nga numri i serviseve që janë të pastra në këtë drejtim. "Nuk do të thotë që të kemi 100 kanale me lloj-lloj marrëzrash, pa asnjë farë kualiteti. Është shumë më mirë të kemi 20 kanale të standardizuara, se sa këtë kaos që e kemi", thotë Stefanoski.

Akoma në Maqedoni mbretëron pirateria, thotë Stefanoski, por për fat, tashmë kemi filluar të zgjohemi dhe të kërkojmë zgjidhje ligjore për këtë problematikë. "Edhe në Këshillin për radiodifuzion piraterinë duhet ta zgjidhim në mënyrë sistemore, kjo nënkupton krijimin e një plani aksional dhe suazën kohore dhe mbi të gjitha më tepër kompetenca për Këshillin për Radiodifuzion", thotë ai. (vazhdon)

*(Hulumtimi është realizuar me mbështetjen e projektit SCOOP dhe Shoqatës daneze të gazetarëve hulumtues)*

**BORDI I RTVM-SË SJELL**

**VENDIM**

## Shkarkohet Sajovic

Bordi Drejtues i Radiotelevizionit të Maqedonisë ka shkarkuar nga detyra drejtorin ekzekutiv të këtij servisi publik, Janez Sajovic.

Sajovic, me shtetësi slovene dhe konsulent i OSBE-së për media, ishte një nga drejtorët e zgjedhur si ekspertë i huaj për të zgjidhur dhe reformuar RTVM-në,

Ai me anë të një letre kërkoi prishjen e kontratës së tij për shkak të siç theksoi obstrukcioneve dhe keqpërdorimeve të bëra nga Bordi Drejtues i RTVM-së.

Komisioni Shtetëror Antikorrupsion në fillim të këtij muaji akuzoi Janez Sajovicin për keqpërdorim të detyrës dhe fondeve të servisit publik informativ.

**MINISTRIA E ARSIMIT**

**PËRMIRËSON GABIMIN**

## Bërvenicës i kthehen kompetencat

Ministri i Arsimit dhe Shkencës, Pero Stojanovski ka vendosur që t'ia kthejë kompetencat në sferën e arsimit, kryetarit dhe këshillit të Komunës së Bërvenicës. Këtyre të fundit, kompetencat iu morrën kohë më parë nga ana e ish-ministrit Sulejman Rushiti, edhe ate pikërisht gjatë shkarkim-emërimeve të reja të drejtorëve të shkollave. Kryetari i Komunës së Bërvenicës Xhelal Ramadani pohon lajmin se ministri aktual do t'ia kthejë kompetencat e marra kohë më parë nga ish-ministry Sulejmani. Ai nënvizon se në një takim me gazetarët që do ta realizojë së shpejti do të flasë në hollësi për të gjitha procedurat se si ka arrdhë deri në marrje dhe tash kthim të kompetencave në sferën e arsimit. (G.I.)

**MATURA SHTETËRORE NË TETOVË**

## 200 nxënës në afatin e dytë

Në shkollat e mesme në Maqedoni u mbajt afati i dytë i dhënies së maturës shtetërore. Provimit i janë nënshtruar maturantët, të cilët nuk e kanë dhënë ose pjesërisht e kanë dhënë provimin në afatin e qershorit. Për dhënien e maturës në sesionin e gushtit janë paraqitur 3.645 kandidatë. Maturantët, patën provimin për gjuhë amtare (maqedonisht, shqip, turqisht ose serbisht), ndërsa testimi filloi në orën nëntë. Në Tetovë provimit i janë nënshtruar mbi 200 nxënës dhe provimi është mbajtur në lokalet e gjimnazit të Tetovës", thotë Fadil Lushi, udhëheqës i Byrosë për Zhvillimin e Arsimit në Tetovë. (G.I.)

**PËR 15 MUAJ MPB KA NGRITUR 55 PADI PENALE**

Të dhënat e Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB) flasin për një sërë materialesh pirate të zëna, një pjesë e së cilës është shkatërruar, ndërsa një pjesë tjetër ka mbetur në labirintet e gjyqeve. Për një vit e tre muaj policia ka konfiskuar 186 mijë materiale pirate dhe janë ngritur 55 padi penale. Nga Sektori për kriminalistikë pranë MPB-së sqarojnë se vetëm gjatë vitit 2007 nga kontrollet e kryera në objekte tregtare, internet klube, objekte dëfrimi dhe tezga janë konfiskuar mbi 111 mijë materiale pirate, DVD, CD, MP -3 dhe audio kaseta me përmbajtje të ndryshme. Në kuadër të këtyre aktiviteteve janë ngritur 32 padi penale kundër 36 kryerësve, pronarë të DVD klubeve, firma private dhe persona fizik. Paditë janë ngritur për dëmtimin e të drejtave autoriale si dhe nga një padi penale për veprën e kryer "përdorimi i firmës së huaj në mënyrë të paautorizuar dhe "mashtrim i blerësve". Ndërkaq, gjatë tre muajve të parë të vitit 2008 gjatë kontrolleve janë gjetur dhe konfiskuar mbi 74 mijë materiale pirate, DVD, CD, MP -3 dhe audio kaseta, me përmbajtje të ndryshme, ndërsa pas dokumentimit të rasteve janë ngritur 23 padi penale ndaj 23 kryerësve të krimit, pronarë të DVD klubeve, firma private dhe persona fizik, për kryerjen e 19 veprave penale "shkelje e të drejtave autoriale" dhe pesë padi penale për "pirateri të pjesëve audio vizuale". Ljubomir Gjyrcovski, ndihmës drejtor në sektorin e kriminalistikës thotë se të dhënat e tjera për rrugët e këtij lloji të falsifikimit mbahen sekret, pasi policia tashmë është duke punuar në gjetjen e tyre.